FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 154

Tiranë – E mërkurë, 26 gusht 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 103/2020 datë 29.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 28, datë 2.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, 'Për buxhetin e vitit 2020', të ndryshuar".....	9729
Ligj nr. 104/2020 datë 29.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 30, datë 20.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19', të ndryshuar".....	9729
Ligj nr. 105/2020 datë 29.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin".....	9729
Ligj nr. 106/2020 datë 29.7.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.....	9733
Ligj nr. 107/2020 datë 29.7.2020	Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.....	9734
Ligj nr. 114/2020 datë 29.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".....	9734
Dekret i Presidentit nr. 11656, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Tiranës.....	9737
Dekret i Presidentit nr. 11657, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.....	9737
Dekret i Presidentit nr. 11658, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit Politeknik të Tiranës.....	9737
Dekret i Presidentit nr. 11659, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës.....	9738

Dekret i Presidentit nr. 11660, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.....	9738
Dekret i Presidentit nr. 11661, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Arteve.....	9738
Dekret i Presidentit nr. 11662, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.....	9739
Dekret i Presidentit nr. 11663, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan....	9739
Dekret i Presidentit nr. 11664, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.....	9739
Dekret i Presidentit nr. 11665, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.....	9740
Dekret i Presidentit nr. 11666, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.....	9740
Dekret i Presidentit nr. 11667, datë 24.8.2020	Për emërimin e rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër.....	9740
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 32, datë 25.8.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	9741
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 299, datë 29.7.2020	Për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor.....	9741
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 726/4, datë 21.8.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i shëtitores së qytetit Bajram Curri", Bashkia Tropojë.....	9743

LIGJ
Nr. 103/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 28, DATË 2.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 88/2019, 'PËR BUXHETIN E VITIT 2020', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 28, datë 2.7.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, 'Për buxhetin e vitit 2020', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 104/2020

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 30, DATË 20.7.2020 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 30, datë 20.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, 'Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19', të ndryshuar".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 105/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 79/2017 "PËR SPORTIN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 7 të nenit 3 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

"7/1. "Karta e tifozit" është një marrëveshje ndërmjet tifozëve dhe organizatës sportive, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatës sportive ndaj tifozëve të saj dhe anasjelltas, sanksionet bazë për rastet e shkeljes së kësaj marrëveshjeje, si dhe rregullat për mbarëvajtjen e veprimtarisë sportive brenda e jashtë vendit.".

Neni 2

Në nenin 7, "Sporti në Republikën e Shqipërisë", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik.".

Neni 3

Neni 13, "Financimi i organizatave sportive", ndryshohet si më poshtë:

"1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transferte, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Financimi i federatave sportive olimpike, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizatës Kombëtare Antidoping përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për sportin.

3. Ministria përgjegjëse për sportin financon federatat joolimpike me projekte nga buxheti i saj në formë transferte për veprimtari të propozuara prej tyre, duke pasur në konsideratë impaktin social, ekonomik dhe mjedisor.

4. Ministria përgjegjëse për sportin mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë dhe administrimin e transfertës së buxhetit të shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike.".

Neni 4

Në nenin 16, "Federatat sportive", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Të drejtën për të përfituar emërtimin "Federatë shqiptare" e një sporti të caktuar e gëzon ajo organizatë sportive, e krijuar me nismën e personave juridikë dhe/ose personave fizikë të atij sporti, të organizuar sipas legjislacionit për organizatat jofitimprurëse ose tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të cilat kanë pranuar emërtimin dhe statutin e federatës.".

Neni 5

Në nenin 17, "Emërtimi "Federatë shqiptare", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Akti i emërtimit "Federatë shqiptare" i një sporti i revokohet një organizate sportive nga ministri përgjegjës për sportin. Ky i fundit kërkon nga gjykata kompetente heqjen e emërtimit nëse:

a) veprimtaria e saj nuk zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statut;

b) nuk zhvillohet çdo vit Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Shqipërisë;

c) nuk zhvillohet asambleja vjetore;

ç) nuk zhvillohet asambleja zgjedhore sipas ciklit olimpik.".

Neni 6

Neni 21, "Klubet sportive", ndryshohet si më poshtë:

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse ose tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Çdo organizatë, që ka personalitet juridik, ka të drejtë të krijojë një shoqatë sportive amatore sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, e cila organizohet dhe funksionon në bazë të aktit themelues të organit krijues.

3. Transformimi i klubeve sportive sipas pikës 1 të këtij neni, realizohet me vendim të organit krijues brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Klubet sportive sipas pikës 1 të këtij neni, përfitojnë financime nga organet e pushtetit vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera të ligjshme.".

Neni 7

Pas nenit 21, "Klubet sportive", shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 21/1
Karta e tifozit

1. Karta e tifozit lëshohet nga organizata sportive pas anëtarësimit të tifozit, sipas llojit të veprimtarisë sportive që kjo organizatë ushtron.

2. Karta e tifozit përmban rregulla për çështjet e anëtarësisë, konsultimin e informimin, aksesin dhe përdorimin e stadiumeve, sigurinë e mbrojtjen e spektatorit, tregtimin lidhur me shitjen e biletave, aktivitetet e adresuara komunitetit, si dhe rregulla të

tjera kundër racizmit, dhunës, ksenofobisë apo diskriminimit në futboll.

3. Rregullat për procedurën dhe mënyrën për pajisjen me kartën e tifozit përcaktohen në rregulloren e brendshme të organizatës sportive.

Neni 8

Neni 22, "Kapitali shtetëror", ndryshohet si më poshtë:

1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

3. Nëse në përfundim të periudhës njëvjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

Neni 9

Neni 24, "Zgjidhja e mosmarrëveshjeve", ndryshohet si më poshtë:

1. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit organizohet dhe funksionon Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.

2. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjial, i cili vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin.

3. Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet në Asamblenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

4. Çdo organizatë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual ka të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjeve përpara Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

5. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat shqiptare të sportit, klubet sportive, shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv. Ky detyrim përfshihet në statutet përkatëse brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 10

Neni 27, "Sporti dhe statusi i sportistit të nivelit të lartë", ndryshohet si më poshtë:

"Neni 27
Sportisti, trajneri dhe statusi i sportistit të nivelit të lartë

1. Sportistët që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare:

a) "rekord olimpik", "rekord botëror", "rekord europian", "rekord mesdhetar", "rekord ballkanik", "vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike", "vendi i parë deri në të tetin në kampionate botërore" dhe "vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate europiane", përfitojnë trajtimin, shpërblimin dhe integrimin në sistemin arsimor me drejtim sportiv, sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes, punësimin në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.

b) "vendi i parë deri në vendin e tretë në Lojërat Mesdhetare" dhe "vendi i parë në "Kampionatin Ballkanik"", përfitojnë trajtimin, shpërblimin, integrimin në sistemin arsimor me drejtim sportiv, sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes.

c) sportistët e sporteve individuale, sipas federatave përkatëse, përfitojnë këtë status për klasifikime në veprimtaritë ndërkombëtare referuar parashikimeve të pikës 1, shkronjave "a" dhe "b" të këtij neni, sipas përcaktimeve në rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive.

2. Institucionet e arsimit të lartë publik, që ofrojnë programe studimi me drejtim sportiv, siguri kombëtare dhe mbrojtje, sigurojnë kryerjen e studimeve pa konkurs dhe sipas një plani individual për sportistët, të cilët plotësojnë kriteret e përfitimit të statusit të sportistit të nivelit të lartë sipas pikës1 të këtij neni.

3. Institucionet e arsimit të lartë jopublik, që ofrojnë programe studimi me drejtim sportiv, sigurojnë ndjekjen e studimeve sipas një plani individual për sportistët që përfitojnë statusin e sportistit të nivelit të lartë sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Në veprimtari kombëtare zyrtare:

a) sportisti i cili thyen rekordin kombëtar dhe vendi i parë në kampionatin kombëtar për të rritur në sportet individuale, të përcaktuara në rregulloret e federatave përkatëse, përfitojnë trajtimin dhe shpërblimin nga fondet e njësive të qeverisjes vendore;

b) sportistët që fitojnë vendin e parë në kampionatin kombëtar të kategorisë më të lartë në sportet kolektive, të përcaktuara në rregulloret e federatave përkatëse, përfitojnë trajtimin dhe shpërblimin nga fondet e njësive të qeverisjes vendore.

5. Kriteret, mënyra e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 11

Neni 34, "Destinacioni dhe privatizimi i objekteve sportive", ndryshohet si më poshtë:

"Neni 34
Destinacioni i objekteve sportive

Destinacioni i objekteve sportive publike nuk mund të ndryshojë, pavarësisht nga subjekti administrues.".

Neni 12

Në nenin 36, "Transmetimi i veprimtarive sportive", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Të ardhurat e përfituara nga e drejta e transmetimit audioviziv u kalojnë organizatorëve të veprimtarisë sportive në masën njëqind për qind.".

Neni 13

Në nenin 45, "Kontrolli mjekësor në sport", pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Agjencisë së Shërbimit të Sporteve.".

Neni 14

Në nenin 45, "Kontrolli mjekësor në sport", pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Organizatorët e veprimtarive sportive sigurojnë vendosjen dhe respektimin e protokolleve higjieno-sanitare gjatë zhvillimit të tyre, me qëllim frenimin e përhapjes së sëmundjeve infektive.".

Neni 15

Neni 50, "Detyrimi për njoftimin e Policisë së Shtetit", ndryshohet si më poshtë:

" 1. Organizatori i një veprimtarie sportive është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim, të paktën shtatë ditë kalendarike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj.

2. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) dhe/ose policinë bashkiake, shoqatën e vullnetarëve, agjenci të specializuara të shërbimit, të kontraktuara për marrjen e masave të sigurisë dhe shërbimit në mjediset sportive.".

Neni 16

Në nenin 51, "Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Administratorët e objekteve dhe mjediseve sportive, në bashkëpunim me organizatorët e veprimtarisë, nëpërmjet shoqërive private të sigurisë fizike dhe/ose policinë bashkiake, shoqatën e vullnetareve, agjenci të specializuara të shërbimit duhet të marrin këto masa:

a) të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;

b) të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;

c) të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;

ç) të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.".

Neni 17

Në nenin 51, "Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike", pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Masat e sigurisë , përgjegjësitë dhe mënyra e ruajtjes së sigurisë në veprimtaritë sportive dhe

ndeshjeve të futbollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 18

Në nenin 52, "Roli i oficerit të sigurisë", pika 1 ndryshohet si më poshtë:

" 1. Në veprimtaritë ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, organizatorët e veprimtarive sportive dhe ndeshjeve të futbollit marrin masa për sigurinë e ekipeve nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë."

Neni 19

Në nenin 53, "Ndalimi i hyrjes në mjediset sportive", pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Personave të cilëve u është ndaluar hyrja në objektet dhe mjediset sportive, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, detyrohen të paraqiten fizikisht pranë komisariateve policore përkatëse në ditën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë sportive, në të cilën u është ndaluar hyrja.".

Neni 20

Në kreun XII, "Kundërvajtjet administrative", në nenin 55, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Shkelja e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga njëqind mijë deri në pesëqind mijë lekë.".

Neni 21
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8 dhe15 të këtij ligji.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 106/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 16, "Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "a", fjalët "dhe që janë të regjistruar për TVSH-në" zëvendësohen me fjalët "me të ardhura mbi 8 000 000 lekë në vit".

2. Në shkronjën "c" hiqen fjalët "kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar".

Neni 2

Pika 1 e nenit 28, "Shkalla tatimore", ndryshohet si më poshtë:

"1. Shkalla e tatimit mbi fitimin është:

a) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.

b) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 107/2020

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 8/1, pas pikës 10 shtohet pika 10.1 me këtë përmbajtje:

"10.1 Pagat dhe shpërblimet e çdo lloji të sportistëve, që kanë kontrata të rregullta me klubet sportive, të cilat njihen nga federatat përkatëse sportive, të përfituara gjatë periudhës 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2022.".

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2021.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

LIGJ
Nr. 114/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 45, DATË 30.4.2015 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 45, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ky ligj zbatohet për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"Autoriteti" është Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, organ kolegjial me kompetencat dhe përgjegjësitë sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe që organizohet e

funksionon sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"Bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit" është çdo person që vërtetohet se ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me organet e ish-Sigurimit të Shtetit, në veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr.7514, datë 30.9.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist, për të cilët disponohen dosje, kartela ose regjistrime në indekset e kartotekave të ish-Sigurimit të Shtetit.".

3.Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"Anëtarë të ish-Sigurimit të Shtetit" janë punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune, të cilët kanë pasur funksione zyrtare në strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, ku përfshihen: oficer, nënoficer, nëpunës, punonjës operativ deri te punonjësi i nivelit të lartë drejtues i ish-Sigurimit të Shtetit.".

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"Person i zhdukur", sipas fushës së veprimit të këtij ligji, është personi i arrestuar, i burgosur, i rrëmbyer ose të cilit i është hequr liria në çdo formë tjetër nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shkëputur nga mbrojtja e ligjit.".

Neni 3

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 9/1
Kompetencat e Kryetarit

Kryetari ka këto kompetenca:

a) vendos për rendin e ditës, thërret dhe drejton mbledhjet e Autoritetit;

b) ndjek zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) kujdeset për zbardhjen, publikimin, si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit;

ç) përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët;

d) drejton administratën e Autoritetit dhe kujdeset për mbarëvajtjen e veprimtarisë së mbledhjeve të Autoritetit duke siguruar edhe dokumentimin e tyre, ndërmjet të tjerave me anë të regjistrimit audio;

dh) kujdeset për publikimin e veprimtarisë së institucionit në faqen zyrtare apo mjete të tjera komunikimi me publikun;

e) siguron bashkëpunimin institucional të Autoritetit me institucionet vendase dhe të huaja, si dhe në projekte, nisma rajonale, ndërkombëtare, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së Autoritetit;

ë) kryeson grupet e punës për nevoja të ndryshme të Autoritetit, në zbatim të parashikimeve të këtij ligji;

f) propozon kërkesat e Autoritetit për nevoja buxhetore dhe personel apo ndryshime legjislative në organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

g) në ushtrim të kompetencave të veta nxjerr urdhra në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 22/1
Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve

1. Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërorë qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.

2. Rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe vendore për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit parashikohen

në marrëveshje dy apo shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim.

3. Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja "d", fjalët "sipas nenit 30" zëvendësohen me fjalët "sipas nenit 29".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"Autoriteti vë në dispozicion dokumentacionin dhe lejon përdorimin e dokumenteve, për qëllime të verifikimit të parashikuar nga shkronja "d" e pikës 1 të këtij neni."

Neni 6

Në nenin 28, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"Autoriteti vë në dispozicion dokumentacionin dhe lejon përdorimin e dokumenteve për qëllime të verifikimit të parashikuar nga shkronja "d" e pikës 1 të këtij neni.".

Neni 7

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Autoriteti u përgjigjet institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike për zyrtarin që emërohet ose ngrihet në detyrë, për periudhën e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, përkatësisht nëse:

a) ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;

b) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor, i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) figuron ose jo në dokumente të ish -Sigurimit të Shtetit.".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i janë vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i certifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, "Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare", si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", i ndryshuar.".

Neni 8

Në nenin 36 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

"5. Në funksion të edukimit qytetar, me qëllim informimin e qytetarëve për dokumentet dhe veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit në tërësi, dhe me fokus brezat e rinj në veçanti, Autoriteti zhvillon veprimtari që ndihmojnë në formësimin e vetëdijes civile për rindërtimin e narrativës të së shkuarës komuniste, të mbështetur mbi kërkimin shkencor, brenda fushës së veprimit të këtij ligji.

6. Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontraktojë ekspertë të jashtëm. Pagesa e ekspertëve të jashtëm përcaktohet sipas akteve nënligjore në fuqi.".

Neni 9

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor sipas nenit 22/1 të ligjit brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.7.2020.

DEKRET
Nr. 11656, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Artan Hoxha emërohet rektor i Universitetit të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11657, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Arben Gjata emërohet rektor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11658, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Andrea Maliqari emërohet rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11659, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Fatbardh Sallaku emërohet rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11660, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Agron Kasa emërohet rektor i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11661, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kastriot Çaushi emërohet rektor i Universitetit të Arteve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11662, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Kseanela Sotirofski emërohet rektor i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11663, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Skender Topi emërohet rektor i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11664, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Dhimitri Bello emërohet rektor i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11665, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Suzana Golemi emërohet rektor i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11666, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Roland Zisi emërohet rektor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11667, datë 24.8.2020

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 92, germa "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazën e rezultatit të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë sipas nenit 7, pika 2, germa "j", të ligjit nr. 80/2015 nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 4393 prot., datë 19.8.2020,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bektash Mema emërohet rektor i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 32, datë 25.8.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Në nenin 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime", paragrafi "II.TRANSPORT", gërma "a) Transport udhëtarësh", togfjalëshi "deri më 43 %", bëhet "deri më 100 %".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 299, datë 29.7.2020

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE PËR KONSUM NJERËZOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 2, të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019 "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore",

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, sipas fushës së zbatimit të ligjit nr. 8/2019, datë 26.2.2019, "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore", sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

ANEKS 1
LISTA E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE PËR KONSUM NJERËZOR SIPAS FUSHËS SË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 8/2019, DATË 26.2.2019 "PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE"

Klasa e 1-rë	Mish i freskët (dhe të brendshmet), që përfshin: - mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit; - të brendshmet (zorrët), fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre të peshkut), të plota dhe pjesë prej tyre.
Klasa e 2-të	Produkte mishi (të gatuara, të kripur, të tymosur etj.).
Klasa e 3-të	Djathërat.
Klasa e 4-t	Produkte të tjera me origjinë shtazore (vezë, mjaltë, produkte bulmetore të ndryshme përveç gjalpit etj.).
Klasa e 5-të	Vajra dhe yndyrna (gjalpë, margarinë, vaj etj.), që përfshin: - gjalpë, yndyrna dhe vajra të tjera të rrjedhura nga qumështi; - sallo dhe dhjam derri; dhjam i shpendëve; - dhjamë gjedhi, delesh ose dhish; sallo (përfshirë *premier jus*) prodhuar nga këto dhjamëra;

	- stearina e sallos së derrit, vaj salloje, oleostearinë, oleo-margarinë dhe vaj prej dhjamit, jo në formë emulsive apo të përzier apo të përgatitura ndryshe; - dhjamëra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut apo të gjitarëve detarë, nëse janë apo jo të rafinuara; - vajra vegjetale të fiksuara, të lëngshme ose të ngurta, të papërpunuara, të rafinuara ose të purifikuara; - dhjamëra dhe vajra shtazore ose vegjetale, të hidrogjenizuara, të rafinuara ose jo, por jo të përgatitura më tej; - margarinë, imitim lardoje dhe dhjamëra të ngrënshme të përgatitura më tej; - mbetjet e rezultuara nga përpunimi i substancave yndyrore apo i dylleve vegjetale apo prej kafshëve.
Klasa e 6-të	Fruta, perime dhe drithëra, të freskët apo përpunuar, që përfshin: - frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve apo të pjeprave; - zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberët përkatës; - drithërat; - produktet e industrisë bluajtëse; mjaltë dhe niseshte; gluten; inulinë; - përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tjera të bimëve; - pije të tjera të fermentuara (p.sh., musht molle, musht dardhe, hidromel); - uthull dhe zëvendësuesit e uthullës.
Klasa e 7-të	Peshk i freskët, molusqe dhe kafshët guaskore dhe produktet që rrjedhin prej tyre.
Klasa e 8-të	Produkte të tjera, që përfshin: - kafe, çaj dhe erëza, përjashtuar mate; - farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia; - pektin; - sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri apo nga panxhar sheqeri në gjendje të ngurtë; - sheqer tjetër, shurupe sheqeri, mjaltë artificial (i përzier ose jo me mjaltë natyral), karamel; - melasat, me lëndë ngjyruese shtesë ose jo; - sheqer, shurupe, melasë me lëndë shtesë aromatizuese dhe ngjyruese, por që nuk përfshin lëngjet e frutave të cilat përmbajnë sheqer shtesë në çfarëdo mase; - kokrra kakao, të tëra apo të thyera, të papërpunuara apo të pjekura; - lëvozhga, lëkura, guaska e kakaos dhe mbeturina të tjera prej kakaos.
Klasa e 9-të	Ushqime të përgatitura.
Klasa e 10-të	Birrë.
Klasa e 11-të	Çokollatë dhe produkte që rrjedhin prej saj.
Klasa e 12-të	Bukë, torta, kek, ëmbëlsira, biskotat dhe produkte të tjera të furrtarit.
Klasa e 13-të	Pije bërë nga ekstraktet bimore.
Klasa e 14-të	Brumërat.
Klasa e 15-të	Kripë.

KËRKESË
Nr. 726/4, datë 21.8.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i shëtitores së qytetit Bajram Curri", Bashkia Tropojë.

Subjekti kërkues është Bashkia Tropojë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 313 768 (treqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I BRENDSHËM
Romina Kuko

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit: "Rehabilitim i shëtitores së qytetit Bajram Curri"
Bashkia Tropojë

Nr	Emri Mbiemri (Pronari që shpronësohet)	ZK	Nr. pasurisë	Sip. e truallit/ m^2	Çmimi i truallit lekë/m^2	Vlera e truallit/lekë	Pemëtore				Vlera totale	Shënime
							Rrënjë (rrush)	Vlera/lekë	Rrënjë (kumbull, mollë)	Vlera/lekë		
1	Guxim Gjyriqi Agron Gjyriqi Mimoza Metaliaj Valdete Kermaja Xhevahire Gjyriqi	1347	5/26	35	1873	65555	15	7500	5	7500	80555	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Guxim Gjyriqi Agron Gjyriqi Mimoza Metaliaj Valdete Kermaja Xhevahire Gjyriqi	1347	1/212	39	1873	73047	10	5000	5	7500	85547	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Arben Gjyriqi Bedri Gjyriqi Lumturie Gjyriqi Zyrafete Buçpapaj	1347	5/34	35	1873	65555	10	5000	0	0	70555	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Arben Gjyriqi Bedri Gjyriqi Lumturie Gjyriqi Zyrafete Buçpapaj	1347	5/48	38.5	1873	72111	10	5000	0	0	77111	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma					**276268**	**45**	**22500**	**10**	**15000**	**313 768**	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 154
Datë: 2020/08/26 13:56:29
09061131-8887-41f7-b901-75b7329cb4a1

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë